

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap – Kž – 67/2011

29 maj 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarit të EULEX-it Horst Proetel dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Salih Toplica, Nebojša Borčić dhe Marije Ademi si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Noora Aarnio si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër të pandehurit **D. N.**

i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë për vepra penale të **Vrasjes** në bashkëkryerje [neni 30 paragrafi 2 pikat 1 dhe 4 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPK) lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste federative të Jugosllavisë (LPRSFJ)], sepse te Ura e Jakës në fshatin Marmullë, Komuna e Pejës, më 19 mars 2004, i pandehuri bashkë me **A. N.** dhe **S. N.** kanë shtënë në drejtim të **D. A. t** dhe **T. A.** që rezultoi me vdekjen e tyre.

Duke vepruar lidhur me ankesën e përbashkët të të pandehurit përmes avokatëve të tij Zenel Mekaj dhe Haxhi Cekaj më 30 dhjetor 2010, dhe

ankesën e palës së dëmtuar përmes avokatit të tij Haxhi Millaku më 5 janar 2011,

kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr 112/2010, të datës 15 tetor 2010 ke të cilin Gjykata e Qarkut shpalli të pandehurin fajtor dhe e dënoi atë me burgim.

Pas seancës së hapur për publik të mbajtur më 29 maj 2012, në praninë e Prokurorit të Shtetit Jusuf Mezini, të pandehurit dhe avokatëve mbrojtës Haxhi Cekaj dhe Nushe Kuke Mekaj në vend të Zenel Mekajt, dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur po të njëjtën ditë,

më 29 maj 2012 shpall këtë,

AKTGJYKIM

D. N. pa nofkë, emri i të atit : _____, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës _____, vendi i lindjes fshati _____, Komuna e Pejës ku edhe jeton, data e lindjes _____, Kosovar,

_____ , nuk është i dënuar më parë, në paraburgim në _____ Zyrtër nga _____ 10 korrik 2007 deri 28 maj 2008 kur i pandehuri u ekstradua në Kosovë dhe nga _____ 29 maj 2008 e këtij në Kosovë.



Ankesa e ushtruar në emër të të pandehurit dhe ankesa e ushtruar në emër të palës së dëmtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr 112/2010, të datës 15 tetor 2010 refuzohen si të pabazuara.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut vërtetohet.

Shpenzimet e procedurës penale në shkallë të dytë do t'i mbulojë i pandehuri në përputhje me nenet 99, 100 dhe 103 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

ARSYETIMI


I HISTORIA E PROCEDURËS

1. Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit në datë të paspecifikuar. Më 30 dhjetor 2010 avokatët mbrojtës Zenel Mekaj dhe Haxhi Cekaj ushtruan një ankesë të përbashkët kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Për t'i garantuar të pandehurit të drejtën e tij për mjet efektiv juridik siç përcaktohet me nenin 398 të KPPK-së ankesa duhet të supozohet se është ushtruar brenda afatit.
2. Aktgjykimi i është dorëzuar përfaqësuesit të palës së dëmtuar në datë të paspecifikuar në mes 15 tetorit dhe 21 dhjetorit 2010. Më 5 janar 2011 përfaqësuesi ligjor Haxhi Millaku ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Për t'i garantuar palës së dëmtuar të drejtën e tij për mjet efektiv juridik siç përcaktohet me nenin 398 të KPPK-së ankesa duhet të supozohet se është ushtruar brenda afatit.

II ANKESAT DHE PËRGJIGJET E PROKURORISË

1. Ankesa e D

3. Ankesa e N pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të procedurës penale dhe të kodit penal, se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë, dhe sanksioni penal është shqiptuar paligjshëm.
4. Avokatët mbrojtës kërkojnë të ndryshohet aktgjykimi duke e shfajësuar të pandehurin në përputhje me nenin 390 paragrafin 1 pikën 3 të KPPK-së. Nëse kjo nuk arrihet të bëhet, atëherë aktgjykimi duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në Gjykatë të qarkut për rigjykim.
5. Arsyet e parashtruara për ankesë janë përmbledhur si në vijim:



6. Së pari, aktgjykimi i ankimuar është i bazuar në prova të papranueshme – më saktësisht në dëshmi të M. B. M. B. dhe P. E. të dhëna në gjykimet e tjera. Këto janë të papranueshme sepse avokati mbrojtës nuk ka pasur rastin të rimerr në pyetje dhe ta kundërshtojë dëshmitarin. Po ashtu edhe dëshmia e Nikollës është e papranueshme për shkak të njëanshmërisë së saj.

7. Së dyti, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt sepse bazohet në dëshmi të pjesshme dhe jo-objektive. Prokurori i mëparshëm i lëndës dhe L. A. nuk kanë kursyer asnjë mjet e metodë për t'ia lënë fajin D. Nokajt. Vilson Nikolla, Gjon Nikolla dhe Gjin Pregoni pritet ta përkrahin palën e dëmtuar për shkak të marrëdhënies së tyre. Dëshmitarët Allakaj, Vilson Nikolla, Gjon Nikolla, Mikel Berisha dhe Mhill Berisha mundoheshin t'i unifikonin dëshmitë e tyre. Dëshmitë e Vilson Nikollës, Gjon Nikollës dhe Gjin Pregonit janë në kundërshtim me dëshmitë e Anton Nikollës, Zef Delijajt, Robert Delijajt, Pren Hilit dhe të tjerëve. Përveç kësaj, disa nga dëshmitë fare nuk u shqyrtuan. Po ashtu, ekspertiza balistike “nuk mund të merret si e vërtetë absolute..”¹. Për më shumë, vonesa e gjatë në mbledhjen e provave vërteton se akuzat janë trillime. Po ashtu, disa dëshmitarë ishin kërcënuar. Si përfundim, nuk ekziston asnjë provë që vërteton përtej dyshimit të arsyeshëm fajësinë e Danil Nokaj.

8. Së treti, nga vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike rrjedh edhe shkelja e ligjit penal. Edhe nëse Danil Nokaj ishte i pranishëm, madje edhe nëse ka shtënë në viktimat, nuk mund të vërtetohet se veprimet e tij kanë shkaktuar ato vdekje. Më tuje, dashja e Anton Nokajt ishte ta vrasë Dedë Allakajn por nuk kishte dashje për ta vrarë Tunën. Aktgjykimi nuk jep arsyetim për “brutalitetin” pasi që thjesht vetëm përdorimi i shumë plumbave nuk përbën brutalitet.

9. Së fundi, dënimi nuk është matur drejt pasi që përfshirja ose kontributi i Danil Nokajt nuk është shprehur në aktgjykim. Pasi që ai nuk ka shkaktuar vdekjet ai nuk duhet të dënohet aq ashpër sikurse dy të pandehurit e tjerë.


2. Ankesa e palës së dëmtuar

10. Ankesa e palës së dëmtuar kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me sanksionin penal të shqiptuar.

11. Pala e dëmtuar kërkon që aktgjykimi të modifikohet duke shqiptuar dënim më të rëndë për të pandehurin. Dënimi nuk është në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe dëmtimet e shkaktuara nga veprimet e tij. Vepra ishte e planifikuar dhe përgatitur mirë. I pandehuri qartë ka dashur vdekjet pasi që ai festoi të arriturat e tij duke shtënë në ajër. Si rezultat dy burra të rinj, kryefamiljar me fëmije, janë vrarë.

12. Gjykata nuk i ka kushtuar vëmendje të duhur faktit që veprimet e Danil Nokajit vetëm që kanë kërcënuar viktimat por gjithashtu përmbajnë një traditë primitive të regjionit e cila supozohet të ruajë reputacionin e familjes në një mënyrë të tillë dhe

¹ Ankesa e Danil Nokajt, e datës 28.12.2010, faqe 4 e versionit në gjuhën angleze



kështu duk e paraqitur në mënyrë të rreme atë si një veprim të respektueshëm apo prestigjioz. Duhet t'i kushtohet vëmendje që D. N. u përpoq t'i shmangej përgjegjësisë penale duke ikur nga Kosova.

13. Dënimi i shqiptuar nga Gjykata e Qarkut nuk ka arritur qëllimin e dënimit sikurse përcaktohet me Nenin 34 të KPK.

14. **Mendimi i Prokurorit Publik**

Prokurori Publik nuk ka paraqitur mendimin e tij.

3. **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

15. Prokurori i Shtetit i propozon Gjykatës Supreme të miratoj ankesën e palës së dëmtuar dhe të refuzoj ankesën e të pandehurit si të pabazuar.

16. Nuk ka pasur shkelje të procedurës penale. Aktgjykimi nuk është bazuar në prova të papranueshme, në anshmëri dhe dëshmi jo qenësore. Më tej, të gjitha dëshmitë janë vlerësuar. Gjykata nuk është mbështetur në një provë të vetme por në një numër të konsiderueshëm të provave. Mbrojtjes i është dhënë mundësia për të kundërshtuar të gjitha provat në shqyrtimin gjyqësor.


17. Gjykata e Qarkut ka arsyetuar vërtetimin e fakteve në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Fillimisht aktgjykimi përshkuan deklaratimet. Pastaj ai i vlerëson këto deklaratime dhe sqaron faktet që dalin nga këto deklaratime. Aktgjykimi qartë shpjegon elementet e konfirmimit si edhe pse i ka konstatuar disa deklaratime të jenë të vërteta dhe disa jo të vërteta.

18. Faktet janë vërtetuar në mënyrë korrekte.

19. Ligji penal është zbatuar në mënyrë korrekte.

20. Megjithatë, Gjykata e Qarkut nuk i ka vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të duhur rrethanat e tërësishme kur ka kalkuluar dënimin. Faktet lehtësuuese, se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë dhe se është baba, janë mbi vlerësuar. Gjykata nuk ka aplikuar rrethanën rënduese të rrezikut social të cilin e ka krijuar krimi – marrëdhëniet e rënuara në mes të dy familjeve – dhe pasojat serioze të veprës penale. Po ashtu, vendi dhe rrethanat e veprës penale janë faktor të tjerë rëndues. Së fundi, numri i plumbave të shkrepur tregon që kryerësit ishin të vendosur t'i vrisnin viktimat.

III GJETJET E GJYKATËS



A. Lejueshmëria e ankesës

21. Gjykata Supreme konstaton që ankesat janë ushtruar brenda 15 ditëve sikurse është përcaktuar me Nenin 398 të KPPK dhe prandaj janë në kohë dhe të pranueshme. Ankesat janë ushtruar nga avokatët mbrojtës dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, pra personat e autorizuar.

22. Kolegji tani do të vlerësoj secilin argument të ngritur në ankesat e mbrojtjes.

B. Shkelje të supozuara të Kodit të Procedurës Penale

23. Ankesa pretendon që deklaratimet e M. B. M. B. dhe P. H. janë të papranueshme sepse ato ishin dhënë në gjykime të tjera dhe avokati mbrojtës nuk ka pasur mundësin t'i marrë në pyetje dhe kundërshtoj këta dëshmitarë.

24. Në lidhje me deklarinimin e M. B. , Gjykata Supreme vëren se Gjykata e Qarkut ka deklaruar që *"Gjykata ka zgjedhur që të mos mbështet në provat e M. B. në bërjen e aktgjykimit. I pandehuri nuk e ka pasur mundësin të kundërshtoj provën e M. B. në gjykimin e tij të parë dhe i ishte mohuar mundësia të kundërshtoj atë provë, gjykata ka arritur në përfundimin se nuk do të jetë në interes të drejtësisë të mbështetet në të."*² Prandaj, Gjykata Supreme e konsideron të panevojshme të deklaroj më tej për pranueshmërinë e këtij dëshmitari pasi që është thjesht çështje teorike jo relevante në këtë lëndë.


25. Në lidhje me deklarinimin e M. B. , Gjykata Supreme vëren se ky dëshmitar është dëgjuar në gjykim kështu që mbrojtja ka pasur rastin të kundërshtoj të gjitha këto deklarime. Prandaj, ky pohim është i pabazuar.

26. Në lidhje me deklarinimin e P. H. Gjykata Supreme vëren se ai është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor të parë të të pandehurit, më 3 maj 2009, kështu që mbrojtja ka pasur mundësin të kundërshtoj të gjitha deklaratimet e tij. Prandaj ky pohim është i pabazuar.

27. Ankesa gjithashtu përmban që deklarimi i Nikolla është i papranueshëm për shkak të anshmërisë së tij. Gjykata Supreme rithekson se është prerogativë e trupit gjykues për të vlerësuar provat e paraqitura. Ky vlerësim përfshin ekzistimin e paragjykimëve të supozuara.

C. Mungesë e supozuar e provave dhe vlerësim jo i duhur apo i gabuar i provave të paraqitura.

² Aktgjykimi i datës 15 tetor 2010, faqe 21 e versionit në gjuhën angleze



28. Siç u theksua më sipër është prerogativë e trupit gjykues për të vlerësuar provat e paraqitura madje edhe kur janë kontradiktore. Kjo ndodh për shkak se Gjykata e Qarkut, pasi dëgjimit të drejtpërdrejtë të provës është në pozitën më të mirë për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarëve dhe / apo të ekspertit. Është detyrë e Gjykatës Supreme të përcaktoj nëse gjykata e ka bërë vlerësimin e saj si duhet. Rishikimi i Gjykatës Supreme në vlerësimin e Gjykatës së Qarkut prandaj është i kufizuar në pyetjet nëse faktet janë zbuluar me kujdes, nëse provat e paraqitura janë të pranueshme dhe nëse vlerësimi është i besueshëm, logjik dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka maturi në vlerësimin e provave që Gjykata Supreme nuk do të ndërhyj përderisa aktgjykimi i ankimuar nuk i shkel rregullat e kuptimit logjik dhe të përgjithshëm. Gjykata Supreme rivlerëson provat nëse konstaton se vlerësimi i gjykatës është i gabuar.

29. Ankesa përmban se ekspertiza balistike *“nuk mund të trajtohet si një e vërtetë absolute.”*³ Gjykata Supreme nuk është e bindur në këtë pohim. Eksperti i balistikës ka punuar për mjekësin ligjore në Prishtinë, ku ai, gjatë kohës së gjyqimit ka punuar për dy vjet. Ai po ashtu qartë ka pranuar se disa ekzaminime nuk mund të bëhen apo ishin jashtë objektit të tyre të shqyrtimit.⁴ Në këtë mënyrë ai ka pranuar kufijtë e mjekësisë ligjore në këtë lëndë. Si rrjedhojë, nuk ka arsye për të vënë në pikëpyetje raportin e mjekësisë ligjore i cili përmban se kishte fishekë të tri armëve të ndryshme në vendin e ngjarjes.

30. Ankesa gjithashtu përmban se pasi që ka kaluar kohë e gjatë nga kryerja e krimit, dëshmitarët janë ndikuar. Informata e parë gjithmonë është më e sakta. Gjykata Supreme vëren se raporti mbi inspektimin e vendit të ngjarjes nga dita e vrasjes përmban që *“sipas burimeve të policisë, dyshohet se kryerësit e krimit janë Anton Nokaj, ... dhe 3 bashkëpunëtorë duke pasur parasysh numrin e gëzhojave nga arma automatikë që janë zbuluar në vendin e ngjarjes ...”*⁵ Kështu që madje edhe në ditën e parë të hetimit ka qenë e qartë se ka pasur më shumë se një kryerës. Gjithashtu, L. A. është dëgjuar së pari nga gjyqtari hetues më 14.4.2004, Gjon Nikolla më 26.4.2004, A. N. më 19.3.2004 dhe më 6.4.2004, P. i H. më 27.4.2004 dhe R. D. më 29.4.2004. Kështu që ata të gjithë janë dëgjuar pothuajse menjëherë pas të shtënave.


31. Deklarata e parë e Z. D. në shkresat e lëndës është e datës 6.4.2005 dhe ajo e Gjin Preqit më 8.8.2005, kështu që ka vonesë në marrjen e tyre në pyetje. Megjithatë, Gjykata Supreme vëren që është e mundur që ata janë dëgjuar më herët lidhur me të pandehurit tjerë por që këto deklarata nuk janë në këto shkresa të lëndës. Gjithashtu, V. N. është dëgjuar më 23.2.2005 nga prokurori kështu që ekziston vonesë në marrjen në pyetje të tij. Gjykata Supreme më tutje vëren që D. N. nuk ka mundur të dëgjohet pasi që ai ishte jashtë Kosovës kështu që nuk ka mundur të arrihet.

32. Si përfundim Gjykata Supreme konstaton që Gjykata e Qarkut ka, siç përcaktohet në nenin 387 të KPPK-së, ekzaminuar me vetëdije secilën provë veçmas dhe në lidhje me të tjerat dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka arritur tek përfundimi sa i përket vërtetimit të faktit të veçantë. Kështu, prova është vlerësuar në mënyrë të duhur. Vlerësimi i fakteve i

³ Ankesa e Danil Nokaj, e datës 28.12.2010 faqja e katërt e versionit në gjuhën angleze

⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor për A. N. dhe R. B. i datës 2 mars 2005, faqet 3-7

⁵ Raporti i Inspektimit të vendit të ngjarjes, i përpiluar më 19.3.2004



bërë nga Gjykata e Qarkut dhe heqjet (zbritjet) e bëra prej tyre janë bazuar në mendim praktik dhe mbi rregullat logjike. Ato janë të besueshme, të arsyeshme dhe bindëse. Nuk ekzistojnë kundërshtime në arsyetim.

D. Shkeljet e pretenduara të kodit penal

33. Ankesa pohon që nga përcaktimi i gabuar i përshkrimit faktik buron shkelja e kodit penal. Gjykata Supreme vëren se pasi që ka gjetur që përshkrimi faktik është përcaktuar i saktë nuk ekziston asnjë shkelje të kodit penal.


34. Ankesa gjithashtu pohon që qëllimi i A. N. ishte ta vrasë D. A. por që ai nuk ishte qëllim të vrasë T. A. Kështu që edhe po të gjendej që A. N. dhe D. N. të kenë vepruar në bashkëpunim D. N. nuk është përgjegjës penalisht për vdekjen e T. A. Ankesa më tutje pohon që edhe po të dëshmohej që D. N. ka shtënë në viktima, nuk mund të vërtetohet që veprimet e tij kanë shkaktuar vdekjet. Kështu që ai nuk është përgjegjës penalisht për vdekjet e tyre.

35. Sipas nenit 11, paragrafit 1 të LP të RSFJ-së “*Është përgjegjës penalisht kryerësi që është i përgjegjshëm⁶ dhe që e ka kryer veprën penale me dashje⁷ ose nga pakujdesia.*” Gjithashtu, sipas nenit 13 të LP të RSFJ-së “*Vepra penale është kryer me dashje kur kryerësi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e ka dashur kryerjen e saj; apo ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të kryerjes ose moskryerjes pasoja e ndaluar mund të vijë dhe ka pranuar ardhjen e saj.*” Për më tepër, sipas nenit 25, paragrafit 1 të LP të RSFJ-së “*Bashkë-ekzekutori është përgjegjës penalisht brenda kufijve të dashjes ose të pakujdesisë së vet, ...*”

36. Gjykata Supreme përkujton që D. N. është gjetur “... armatosur me armë automatike e ka zënë në pritë Dedë Allakaj i cili ishte duke udhëtuar ... së bashku me vëllain e tij T. A. dhe ka shtënë pa kriter në veturën në fjalë...”

37. Gjykata Supreme mendon që personi duhet të kuptoj që të shtënit pa kriter në veturë mund të rezultojë në vdekjen e cilitdo ose në të vërtetë të gjithë personave brenda veturës. Nëse personi zgjedh të shtijë në veturë ai e shpërfill këtë rezultat dhe kështu e miraton vdekjen e të gjithë udhëtarëve. Prandaj, të shtënit pa kriter në drejtim të veturës i përmbush kërkesat e paramendimit siç përcaktohet në LP të RSFJ-së. Kështu, D. N. ka vepruar me paramendim kështu që ai është përgjegjës penalisht për vdekjen e të dyve D. A. dhe T. A.

⁶ Mentally capable: përgjegjëshëm (në gjuhën Shqipe), uraçunljiv (në gjuhën serbe)
⁷ Intent: dashje (në gjuhën shqipe), umišljaj (në gjuhën serbe)



38. Ankesa gjithashtu pohon që Aktgjykimi nuk jep arsyetim për “brutalitet” pasi që përdorimi i shumë plumbave nuk përbën brutalitet.

39. Gjykata Supreme përkujton që Gjykata e Qarkut ka gjetur që kryerësit i kanë vënë pritë viktimave pasi që ata shkuan të kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme dhe e përshkruan veprimet e D. N. “...brenda kontekstit të gjakmarrjes..” dhe “... ekzekutimit publik.”⁸

40. Gjykata Supreme pajtohet me Gjykatën e Qarkut që kombinimi i numrit të të shtënave të shkrepura (duke treguar përcaktimin për të vrarë), mënyra pa kriter e të shtënit në veturë, mënyra me të cilën është kryer vepra (zënia e pritës dhe ekzekutimi publik) dhe motivi i veprës përbën brutalitet.

E. Dënimi


41. Sipas nenit 22 të LP të RSFJ-së “*Në qoftë se disa persona, duke marrë pjesë në veprimin e ekzekutimit ose në ndonjë mënyrë tjetër kryejnë bashkërisht vepër penale, secili nga këta do të dënohet me dënim të parashikuar për këtë vepër.*”

42. Gjykata Supreme përkujton që D. N. është gjetur “...së bashku me Anton Nokaj dhe Simon Nokaj, e gjithashtu edhe personat tjerë aktualisht të panjohur ose në arrati, ... të zënë në pritë.. dhe ka shtënë ...”. Gjykata Supreme mendon që D. N. bashkë ka kryer vepër penale duke marr pjesë në aktin e kryerjes kështu që do të dënohet siç përshkruhet për vepër.

43. Sipas nenit 30, paragrafit 2 të LPK-së kohëzgjatja e burgimit prej së paku dhjetë viteve ose dënim me vdekje do ti shqiptohet personit veprat e të cilit kualifikohen nën pikat 1 deri në 6 të nenit të njëjtë. Megjithatë, sipas nenit 25, paragrafit 2 të Kushtetutës së Kosovës “*Dënimi me vdekje është i ndaluar.*” Gjithashtu, Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/59, neni 1, paragrafi 5 përcakton që “*Dënimi me vdekje hiqet*”, dhe paragrafi 6 më tutje sqaron që “*Për çdo vepër penale për të cilën sipas ligjit në fuqi në Kosovë të datës 22 mars 1989 parashihet dënim me vdekje, dënimi do të jetë me burgim ndërmjet minimumit që parashihet për atë vepër dhe maksimumit prej dyzet (40) vitesh.*” Kështu që shtrirja e dënimit është 10 deri në 40 vite burgim.

44. Duke marr parasysh që Gjykata e Shkallës së Parë e ka shpallur të pandehurin fajtor për dy pika të akuzës së Vrasjes të kryer nga gjakmarrja dhe në mënyrë brutale sipas nenit 30, pikat 1 dhe 4 të LPK-së dhe në lidhje me nenin 22 të LP të RSFJ-së e gjithashtu nenit 30, pikës 3 të LPK atëherë shqiptimi i dënimit të burgimit afatgjatë prej 25 viteve është i drejtë. Dënimi i shqiptuar është në mes të shkallës së përcaktuar prej 10- 40 viteve. Gjykata e Qarkut në mënyrë të saktë ka balancuar rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

⁸ Aktgjykimi i datës 15 tetor 2010, faqe 50 i versionit në gjuhën angleze



45. Gjykata Supreme konsideron që nuk ekziston arsytim për zvogëlimin apo rritjen e dënimit. Dënimi i shqiptuar është proporcional me seriozitetin e veprës penale dhe të rrethanave konkrete në këtë rast të veçantë.

IV PËRFUNDIM

46. Gjykata Supreme konstaton që ankesat janë të pabazuara.

47. Gjykata Supreme nuk e ka pranuar sipas detyrës zyrtare *ex officio* asnjë shkelje të ligjit (neni 415, paragrafi 1 i KPPK-së) të cilët nuk ishin subjekt i ankesës nga mbrojtja.

48. Bazuar në arsytet e lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv.

Data: 29 maj 2012
Ap.-Kž. nr. 67/2011

I përgatitur në gjuhën angleze, në gjuhën e autorizuar.

Kryetar i kolegjit

Procesmbajtëse

Martti Harsia


Noora Aarnio

Anëtar i kolegjit


Anëtar i kolegjit

Horst Proetel

Anëtar i kolegjit


Seal of the Supreme Court of the Republic of Kosovo. The seal is circular with the text "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top and "GJYKATA SUPREME E KOSOVES" at the bottom. In the center, it says "E KOPJES E VERTETON" and "PRAVKA POTVRDJUJE".
Signature: Salih Toplica
Title: Anëtar i kolegjit
Official stamp: Anëtar i kolegjit

49. Nebojša Boričić



Marije Ademi